

DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1

- 1.1 Partia Shqiptare Demokristiane e Kosoves është parti politike e formuar me qëllimin që të realizojë synimet dhe detyrat sipas Statutit dhe Programit.

Neni 2

- 2.1 Emri i plotë i Partisë është: Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës.
2.2 Emri i shkurtër i Partisë është PSHDK.
2.3 PSHDK është themeluar më 04-11-1990, në Gjakovë.

Neni 3

- 3.1 PSHDK-ja vepron në tërë territorin e Kosovës dhe në diasporë.

Neni 4

- 4.1 PSHDK-ën e përfaqëson: Kryetari, zv. Kryetari dhe personat e autorizuar nga Kryetari ose Kryesia.

Neni 5

- 5.1 PSHDK-ja ka vulen dhe shenjën (stemën) e vet. Shenja (stema) e ka formën rrethore me sfond ngjyrë të kaltërt, në qendër të së cilës është simboli kombëtar, shqiponja dykrerëshe, ngjyrë zezë , e rrethuar me 12 yje pesëcepësh me ngjyrë të verdhë, që shprehë numrin e anëtarëve të Unionit Evropian.

Neni 6

- 6.1 PSHDK-ja bashkëpunon me partitë politike me orientim demokratik , e veçmas me ato që kanë për synim integrimin në BE dhe në NATO.
6.2 PSHDK është anëtare e UDKSH-së.
6.3 PSHDK-ja do të punojë për ruajtjen dhe afirmimin e vlerave demokratike si dhe për antarësimin e Kosovës në Unionin Demokratik Europian, si dhe në Internacionalen Demokristiane Botërore, duke përfshirë edhe me asociacionet tjera Politike dhe parlamentare ndërkombëtare.
6.4 PSHDK-ja mundë të hyjë në koalicion me partite tjera demokratike që veprojnë në Kosovë

ORGANIZIMI POLITIK I PSHDK-së

Neni 7

- 7.1 Organet e PSHDK-së janë : Kuvendi, Këshilli i Përgjithshëm Drejtues, Kryesia e Partisë, Kuvendi i Bashkësisë së Degëve, Kryesia e Bashkësisë së Degëve, Kuvendi i Degëve, Kryesia e Degëve, Forumi i Gruas .

Në kuadër të Partisë funksionon edhe Forumi Rinorë Demokristian, si organizatë rinore.

KUVENDI I PSHDK-së

Neni 8

- 8.1 Kuvendi I PSHDK-së si organi më i lartë i partisë:
- Nxjerrë Statutin dhe Programin e PSHDK-së,
 - Zgjedhë dhe shkarkon Kryetarin dhe zv Kryetarin e PSHDK-së,
 - Zgjedhë dhe shkarkon Këshillin e Përgjithshëm Drejtues të PSHDK-së.
- 8.2 Organet nga paragrafi 8.1 i këtij neni ,Kuvendi I zgjedhë me vota të fshefta , ose me aklamacion.
- 8.3 Për Kryetar, zv Kryetar dhe anëtar të Kryesisë së partisë mund të zgjedhet çdo anëtarë I PSHDK-së I cili me angazhimin e tij politik është dëshmuar , dhe që është banorë I Kosovës dhe jeton e vepron në Kosovë.
- 8.4 Kuvendi I PSHDK-së miraton Raportin e punës si dhe Raportin financiar, Kuvendi, njëherazi, harton planin e punës dhe atë financiar , për periudhen në vijim.
- 8.5 Kuvendi I PSHDK-së shqyrton dhe merr vendime përkatëse lidhur me ankesat e anëtarëve ndaj të cilëve janë shqiptuar masa ndëshkimore.
- 8.6 Kuvendi I PSHDK-së nxjerrë dhe miraton Rregulloren e punës së Kuvendit.
- 8.7 Kuvendi I PSHDK-së nxjerrë dhe miraton rregulloren e përgjithshme disiplinore të anëtareve të partisë.
- 8.8 Kuvendi I PSHDK-së merr vendime të tjera sipas Rregullores për punën e Kuvendit.
- 8.9 Kuvendi I PSHDK-së merr vendim për regjistrimin, çregjistrimin, bashkimin me parti tjera , ndërrimin emërtimin të partisë si dhe shuarjen e PSHDK-së.

Neni 9

- 9.1 Mbledhjen e Kuvendit të rregullt zgjedhorë dhe kuvendit të punës , e thërret Kryetari I PSHDK-ës në konsulltim me zv Kryetarin e PSHDK-se, sipas Rregullores së Kuvendit.
- 9.2 Mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të PSHDK-ës e thërret: Kryetari në dakordim me zv Kryetarin e PSHDK-se -së, Këshillin e Përgjithshëm Drejtues të partisë, me 2/3 e votave nga numri I pergjithëshem I anetareve te Keshillit të PSHDK-ës, me 1/3 e numrit të përgjithshëm të delegatëve te nënëshkruar në kërkesën për mbajtje të mbledhjes së Kuvendit.
- 9.3 Mbledhjet e Kuvendit I udhëheqë Kryetari I parties, zv kryetari ose njëri nga nënkryetarët e caktuar nga Kuvendi me shumicë votash, ose me aklamacion.

9.4 Kuvendi mbanë mbledhje të rregullta pune njëherë në vit.

9.5 Mbledhjet e rregullta të Kuvendit zgjedhor mbahen në çdo 4 vite.

Në rast nevojë Kuvendi mbanë mbledhje të jashtëzakonshëm zgjedhore.

9.6 Me rastin e zgjedhjes së anëtarëve të Kuvendit duhet të respektohen këto kritere:

1. Struktura gjinore;
2. Struktura regjionale (të përfaqsohet çdo BD);
3. Anëtarët e Kryesisë dhe të Këshillit të Përgjithshëm Drejtues duhet të kenë përgaditje profesionale serioze.

Neni 10

10.1 Kuvendi I PSHDK-së me mandat 4 (katër) vjeçarë dhe ka gjithsejt 201 delegatë, të cilët zgjedhen në Kuvendet zgjedhore të Bashkësive të Degëve të PSHDK-së në komuna.

10.2 Në këtë numër të delegatëve janë të përfshirë anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm Drejtues, anëtarët e Kryesisë së PSHDK-së, 20 delegat nga diaspora dhe anëtarët të cilët I dërgojnë Bashkësitë e Degëve.

10.3 Kriteret për zgjedhjen e delegatëve për Kuvendin e PSHDK-së I përcakton KPD në bazë të parimit të numrit të votave nga zgjedhjet e fundit nëpër komuna dhe duke e respektuar parimin e përfaqsimin teritorial të Bashkësive të Degëve.

10.4 Kryesia e BD mund të kërkojë nga KPD revokimin e mandatit të delegatit të BD përkatëse nëse nuk është aktiv, nëse ka kaluar në një parti tjetër apo për shkaqe të tjera të shkeljes së Statutit apo Programit, në rast të sëmundjes së rëndë, e cila ia pamundëson aktivitetin partiak si dhe në rast të vdekjes, ndërsa në vend të tij e propozon kandidatin e ri të cilit mandatin ia konfirmon Kuvendi I parë I PSHDK-së.

Neni 11

11.1 Kuvendi I PSHDK-së punon në mënyrë të plotfuqishme nese ka korum, gjysmen plus një delegate nga numri I tërsishëm I delegatëve të zgjedhur. Vendimet në Kuvend mirren me shumicen e votave të delegatëve të pranishëm në Kuvend.

KËSHILLI I PËRGJITHSHËM DREJTUES (KPD) I PSHDK-së

Neni 12

- 12.1 KPD zgjedhë dhe shkarkon Kryesinë e PSHDK-së
- 12.2 KPD përbëhet nga radhet e anëtarëve të Kryesisë së partisë, kryetarët e BD, Kryetarja e forumit të gruas, Kryetari I Forumit Rinor Demokristian, si dhe nga një anëtarë I zgjedhur nga radhët e çdo BD, gjith 55 anetarë.
- 12.3 Me rastin e formimit të ndonjë BD të re, në mënyrë automatike inkorporohen si anëtarë të KPD, kryetari i BD si dhe një anëtare i propozuar nga vet ajo BD dhe mandate iu zgjatë deri në mbajtjen e Kuvendit të pare zgjedhorë.

Neni 13

- 13.1 KPD-ja nga radhët e veta zgjedhë dy nënkryetarë si dhe sekretarin, të cilët zgjedhen me vota të mshefta me shumicen e votive të KPD me kuorum të plotë.
- 13.2 Kryetari I KPD-së është Kryetari I partisë.
- 13.3 Të drejtë kandidimi për nënkryetar dhe sekretar kanë të gjithë anëtarët e KPD për pos anëtarëve të kryesisë në PSHDK-së.
- 13.4 Kryetari, nënkryetarët si dhe sekretari i KPD kanë të drejtë në kompenzimin material për punën dhe aktivitetin e tyre në kryerjen e detyrave partiake.

Neni 14

14.1 Kompetencat dhe detyrat e KPD-së:

- a) KPD është organ I cili funksionon në mes të dy kuvendeve zgjedhore
- b) KPD zbaton politikën dhe detyrat të përcaktuara me Statut dhe Program të PSHDK-së të aprovuar nga ana e Kuvendit.
- c) KPD I përcakton detyrat të cilat duhet ti zbatojë Kryesia e PSHDK-së
- d) KPD po që se e sheh të arsyeshme thërret mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të punës si dhe atij zgjedhorë me 2/3 e anetareve të KPD, me vota të fshefta.
- e) KPD mblidhet një here në 3 muaj dhe shqyrton realizimin nga ana e Kryesisë si dhe I jep detyra të reja për periudhen vijuese.
- f) Në rast nevojë KPD mblidhet edhe më shpesh se njeherë në 3 muaj, mbledhjen e thërret Kryetari, ose zv Kryetari I PSHDK-së.
- g) KPD mund të mblidhet edhe me kërkesen e Kryesisë së partisë në qoftëse për këtë e shohin të arsyeshme Kryetari dhe zv Kryetari I PSHDK-se.

h) Mbledhjen e KPD e udhëheqë Kryetari , ndërsa në mungesë të Kryetarit, mbledhjen e udhëheqë zv. Kryetari I PSHDK-se. Nëse në mbledhje nuk janë të pranishëm kryetari dhe zv. Kryetari atëherë mbledhjen e udhëheqë nënkryetarët apo sekretari I KPD-së.

l) KPD mund të shkarkoj anëtarët e Kryesisë dhe të vendosë për kooptimin e ndonjë anëtari të ri si anëtarë të Kryesisë.

k) KPD do të merr masa si dhe do të largoi nga partia qdo anetar te partise apo anetar te strukturave udheqeqese ne parti, ne qoftese ai apo ajo do te veproi ne kundershitim me statutin e partise, apo vepron ne kundershitim me vendimet e kryesise qendrore.

Neni 15

15.1 KPD nxjerrë Rregulloren e punës së KPD-së, si dhe Rregulloren

mbi përgjegjësitë disiplinore të anëtarëve të KPD të PSHDK-se.

15.2 KPD bjen vendime të cilat janë obligative edhe për Kryesinë e PSHDK-se.

15.3 KPD mund të ngarkoj Kryesinë me detyra dhe kerkon llogari nga Kryesia

Lidhur me përmbushjen e detyrave të përcaktuara..

Neni 16

16.1 Mandati I n/kryetareve ,sekretarit dhe anetareve të KPD mund të Pushojë edhe para afatit:

- a) Neqoftese jep doreheqje me vullneti e tij.
- b) Me largimin e tij nga radhet e parties te shprehura me vullneti e tij.
- c) Me rastin e vdekjes.
- d) Me perjashtim nga radhet e KPD me arsyetim te mospermbushjes se obligimeve sipas Rregullores.
- e) Per shkak te mungeses së pajusitikueshme tri her radhas nga mbledhja, si dhe për arsye të tjera të cilat KPD mund të parashihen me Rregulloren e punes te KPD e cila aprovohet ne mbledhjen e KPD-se.

Neni 17

17.1 KPD vendose lidhur me propozimet të cilat dalin nga radhet e Kryesisë

Se PSHDK-se me shumicen e votave të anëtarëve present në mbledhjen e

KPD-se. Votimi bëhet në mënyrë të fshehtë. Përjashtimisht, me vendimin e shumicës së

anëtarëve të KPD-ës votimi për çështje të caktuara dhe jo shumë të rëndësishme mund të

bëhet në mënyrë të hapur.

Neni 18

18.1 Kryesia e PSHDK-se vendose për koalicionet e mundshme para apo pas

zgjedhjeve, kushtet dhe kriteret për koalicion si dhe nominon kandidatet

e mundshëm nga radhet e PSHDK-se për deputet si dhe anëtarë të

qeverisë sipas rekomandimit të KPD-se.

KRYETARI I PSHDK-së

Neni 19

- 19.1 Kryetarin I PSHDK-se e zgjedhe dhe shkarkon Kuvendi I PSHDK-se.
- 19.2 Kryetari zgjedhet me mandate kater (4) vjeçarë me te drejte rizgjedhje.
- 19.3 Kryetari I PSHDK-se:
- a) Përfaqson PSHDK-ne brenda dhe jashtë vendit,
 - b) Nenshkruan aktet e PSHDK-se,
 - c) Per nga funksioni eshte kryetare I KPD dhe I Kryesise se Partise,
 - d) Se bashku me zv kryetarin , cakton dhe udheheqe mbledhjen e Kuvendit, te Kryesise se PSHDK-se dhe te KPD,
 - e) I raporton Kuvendit dhe KPD-ne per punet e kryera.

Neni 20

- 20.1 Kryetarit te partise mund t'i pushoj funksioni edhe para skadimit te mandatit te parapare ne keto raste:
- a) Me doreheqje,
 - b) Per shkak te angazhimit I cili ia bent e pamundur kryerjen e funksionit per te cilin eshte zgjedhur,
 - c) Per shkak te daljes jashte Kosovës per te jetuar me teper se tre muaj,
 - d) Per shkak te moszbatimit, gjegjesisht mosrealizimit te detyrave dhe vendimeve te Kuvendit, KPD-se apo te Kryesise dhe kur sjelljet e tij bien ndesh me qendrimin dhe politiken e Partise,
 - e) Per shkak te shkëljes se rende te Statutit dhe Programit te PSHDK-se te argumentuara,
 - f) Per shkak te semundjes se rende e cila ia pamundeson aktivitetin partiak,
 - g) Ne rast vdekje,
 - h) Pas perfundimit te mandatit te percaktuar me Statut.

Zv. KRYETARI I PSHDK-së

Neni 21

- 21.1 zv Kryetarin I PSHDK-se e zgjedhe dhe shkarkon Kuvendi I PSHDK-se.
- 21.2 zv Kryetari zgjedhet me mandate kater (4) vjeçarë me te drejtë rizgjedhje.
- 21.3 zv Kryetari I PSHDK-se ,
- a) Perfaqëson PSHDK-ne brenda dhe jashtë vendit
 - b) Nenshkruan aktet e PSHDK-se.
 - c) Eshte anetar I KPD dhe I Kryesise se Partise,
 - d) cakton dhe udheheqe mbledhjen e Kuvendit dhe te Kryesise se PSHDK-se dhe te KPD,
 - f) Raporton Kuvendit dhe KPD-ne per punet e kryera.
 - g) Zëvendëson Kryetarin e PSHDK-ës në rastet kur I njëjti mungon apo është I penguar që ta ushtrojë funksionin e tij.

Neni 22

22.1 zv Kryetarit te PSHDK-se mund t'i pushoj funksioni edhe para skadimit te mandatit te parapare ne keto raste:

- a) Me doreheqje,
- b) Per shkak te angazhimit I cili ia bent e pamundur kryerjen e funksionit per te cilin eshte zgjedhur,
- c) Per shkak te daljes jashte Kosovës per te jetuar me teper se tre muaj,
- d) Per shkak te moszbatimit, gjegjesisht mosrealizimit te detyrave dhe vendimeve te Kuvendit, KPD-se apo te Kryesise dhe kur sjelljet e tij bien ndesh me qendrimin dhe politiken e Partise,
- e) Per shkak te shkeljes se rende te Statutit dhe Programit te PSHDK-se te argumentuara,
- f) Per shkak te semundjes se rende e cila ia pamundeson aktivitetin partiak,
- g) Ne rast vdekje,
- h) Pas perfundimit te mandatit te percaktuar me Statut.

KRYESIA E PSHDKsë

Neni 23

- 23.1 Kryesia e PSHDK-se eshte organ ekzekutiv I partisë , e cila vepron ne mes te dy kuvendeve zgjedhore dhe numron 27 anetare.
- 23.2 Kryesia nga radhet e veta zgjedhe dy nenkryetaret, dy sekretaret dhe arkatarin.
- 23.3 Nenkryetaret, sekretaret dhe arkatarin I zgjedh Kryesia me vota te fshehta, ose me aklamacion, si te vendose kryesia me shumice votash.
- 23.4 Mandati I nenkryetareve, sekretarit, arkatarit zgjate kater (4) vite me mundesi rizgjedhje edhe per nje mandat, ndersa mandate I anetareve te Kryesise qe te rizgjidhen nuk eshte I limituar.
- 23.5 Per punen e saje Kryesia I raporton KPD-se, Kryetarit, zv kryetarit dhe Kuvendit.
- 23.6 Anetaret e Kryesise kan te drejte ne kompenzim material per punen dhe aktivitetin e tyre ne kryerjen e detyrave partiake.

Neni 24

24.1 Anetarit te Kryesise mund t'i pushojë funksioni edhe para skadimit te mandatit te parapare ne keto raste:

- a) Me doreheqje me deshiren e tij,
- b) Per shkak te angazhimit në ndonje funksioni tjetër, I cili ia ben te Pa mundur kryerjen e funksionit te anetarit te Kryesise,
- c) Per shkak te ndërrimit te parties apo largimit nga partia,
- d) Per shkak te mungeses se pajustificueshme gjashtë mujore ne mbledhje te Kryesisë,
- e) Per shkak te moszbatimit, gjegjesisht mosrealizimit te detyrave dhe vendimeve te KPD-se si dhe Kryesise ,apo kur sjelljet e tij bien ndesh me qendrimet dhe politiken e partisë,
- f) Per shkak te shkeljes se statutit dhe programit te PSHDK-se,

- g) Per shkak te semundjes se rende, e cila ia pamundeson aktivitetin Partiak,
- h) Ne rast te vdekjes.

Neni 25

- 25.1 Per zbatimin e dispozitave te nenit 23 te ketij Statute proceduren per shkarkimin e anetarit te Kryesise e inicon Kryesia e partisë, ndersa vendose KPD.

Neni 26

- 26.1 Ne raste te shkarkimit te ndonje anetari te Kryesise, KPD vendose per kooptimin e anetarit te ri te Kryesise I cili do te propozohet nga po e njejta BD qe ka qene anetare I meparshem I Kryesise.
- 26.2 Numri I anetareve te kooptuar ne kryesi nuk mund te jete me I madh se 1/3 e numrit te pergjithshem te anetareve te Kryesise.

Neni 27

- 27.1 Kryesia e PSHDK-se e informon Kuvendin ne takimin e pare per ndërrimet e bëra.
- 27.2 Mandati I anetarit te kooptuar ne Kryesi zgjatë deri ne Kuvendin e pare zgjedhore.

Neni 28

- 28.1 Kryesia e PSHDK-ës jep propozimet per nominimin e personave ne organet shtetore, per numrin e deputeteve dhe emrat per deputet ne zgjedhjet e pergjithshme, ndersa aprovimin e ben KPD.
- 28.2 Kryesia e PSHDK-se ben koordinimin e zhvillimit politik me Kryesite e BD dhe mbane kontakte te vazhdueshme me to.
- 28.3 Kryesia e PSHDK-se harton programin e punes neper periudha dhe te njejtin ia paraqet KPD per aprovim.
- 28.4 Kryesia e PSHDK-se harton raportin e punes per qdo muaj dhe te njejtin ia paraqet KPD per aprovim.

KUVENDI I BASHKËSISË SË DEGËVE TË PSHDK-së

Neni 29

- 29.1 Kuvendi I BD si organ me I larte I BD te PSHDK-se:
- a) Nxjerre dhe miraton rregulloren e punes te kuvendit te punes dhe te atij zgjedhore te BD te PSHDK-se duke u bazuar ne statutin dhe programin e partisë, si dhe duke ju pershtatur rrethanave rajonale te BD.
 - b) Me shumicë të votave: zgjedhe dhe shkarkon kryesine e BD te PSHDK-se, Zgjedhe dhe shkarkon kryetarin e BD,

- c) Keto organe zgjedhen me vota te mshefta, ose me aklamacion.
- d) Zgjedhe dhe shkarkon nje anetar per KPD,
- e) Zgjedhe delegatet me mandate kater vjeqare, per Kuvendin e pergjithshem te PSHDK-se,
- f) Per anetare te Kryesise dhe delegatet per Kuvend te pergjithshem
te BD mund te zgjidhet qdo anetare I partisë I cili me angazhimin e tij politik eshte deshmuar dhe eshte banore I Kosoves, dhe vepron ne Kosove,
- g) Kuvendi I BD miraton raportin e punes si dhe raportin financiar,
njeherit harton planin e punes dhe ate financiar per periudhen ne vijim,
- h) Kuvendi I BD merr vendime te tjera sipas rregullores se punes se Kuvendit dhe gjithnje duke u bazuar ne statutin e partise.

Neni 30

- 30.1 Te gjitha mbledhjet e Kuvendit I udheheqe Kryetari I BD e ne mungese te tij njeri nga nenkryetaret I zgjedhur nga ana e delegateve te Kuvendit me aklamacion.
- 30.2 Mbledhja e Kuvendit, si te punes poashtu atij zgjedhor te BD I therret :
 - a) Kryetari I BD si dhe Kryesia.
 - b) Mbledhja e Kuvendit ne raste nevoje mund ta therras edhe 1/3 delegateve te BD,
 - c) Mbledhjet e rregullta te Kuvendit te punes te BD mbahen njeher ne vit,
 - d) Mbledhjet e rregullta te Kuvendit zgjedhor te BD mbahen ne qdo kater vite, ndersa ne rast nevoje mbahet Kuvendi I jashtzakonshem zgjedhore.

Neni 31

- 31.1 Kuvendi I BD te PSHDK-se me mandate kater (4) vjeqarë e perbejne anetaret e Kryesise se BD si dhe nga tre deri ne pese delegate te caktuar nga qdo dege e BD te zgjedhur ne Kuvendet zgjedhore te degeve.
- 31.2 Numrin prej tre apo pese delegateve e cakton Kryesia e deges prej nga vijne, duke u bazuar ne numrin e anetareve te deges perkatese, ne kete numer bejne pjese edhe kryetaret e degeve (çka nenkupton 1+2 ose 1+4).
- 31.3 Kryesia e Deges mund te kerkoj revokimin e mandatit te delegatit te vet nga Kuvendi I BD sipas nenit 11 te ketij statute.

Neni 32

- 32.1 Kuvendi I BD te PSHDK-se punon ne menyre te plotfuqishme nese ka Kourumin e plote, gjysmen plus nje delegate nga numri I pergjithshem I cili konfirmohet ne fillim te punes se Kuvendit.

KRYESIA E BASHKËSISË SË DEGËVE TË PSHDK-së

Neni 33

- 33.1 Kryesia e BD te PSHDK-se eshte organ ekzekutiv e cila vepron ne mes te dy Kuvendeve zgjedhore dhe numron 11-17 anetare. Numri I anetareve te Kryesise prej 11 apo 17 anetareve e percakton Kuvendi I BD duke u bazuar ne numrin e degeve si dhe ne perfaqësimin territorial brenda komunes.
- 33.2 Kryesine e zgjedh Kuvendi I BD me vota te mshefta ose me aklamacion. Ndersa Kryesia nga radhet e veta zgjedhe dy nenkryetaret, sekretari si dhe arkatarin e Kryesise se BD me shumice te thjeshte te votave.
- 33.3 Mandati I Kryesise, Kryetarit, nenkryetareve, sekretarit dhe arkatarit zgjate kater vite me mundesi te rizgjedhjes
- 33.4 N/kryetaret, sekretarin dhe arkatarin I zgjedhe dhe I shkarkon kryesia me votat mshefta.
- 33.5 Anetaret e Kryesise kan te drejten e kompenzimit material per punen dhe aktivitetin e tyre ne kryerjen e detyrave partiake.

Neni 34

- 34.1 Anetarit te Kryesise dhe Kryetarit mund t'i pushoj funksioni edhe para skadimit te mandatit te parapare ne keto raste:
- a) Me doreheqje me vullnetin e tij,
 - b) Per shkak te angazhimit ne ndonje funksion tjeter I cili ia benë te Pa ëmundur kryerjen e funksionit te anetarit te Kryesise,
 - c) Per shkak te ndërrimit te parties apo largimit nga partia,
 - d) Per shkak te mungeses se pajustificueshme njemujore,
 - e) Per shkak te moszbatimit gjegjesisht mosrealizimit te detyrave dhe vendimeve te Kryesise apo kur sjelljet e tij bien ndesh me qendrimin dhe politiken e partisë.
 - f) Per shkak te shkeljes se statutit dhe programit te PSHDK-se,
 - g) Per shkak te semundjes se rende, e cila I pamundeson aktivitetin.

Neni 35

- 35.1 Per zbatimin e dispozitave te nenit 33 te ketij statyti procedure per shkarkimin e anetarit te Kryesise e nise Kryesia e BD, ndersa vendose Kuvendi.

Neni 36

- 36.1 Ne rast te shkarkimit te ndonje anetari te Kryesise, Kryesia e Deges vendose per kooptimin e anetarit te ri te Kryesise I cili do te propozohet nga po I njejti regjion qe ka qene anetari I meparshem I Kryesise.
- 36.2 Numri I anetareve te kooptuar ne Kryesi nuk mund te jete me I madh se 1/3 e numrit te pergjithshemte anetareve te Kryesise.

Neni 37

- 37.1 Kryesia e BD e informon Kuvendin ne takimin e pare per ndrrimet e bera.
- 37.2 Mandati I anetarit te kooptuar ne Kryesi zgjate deri ne Kuvendin e Pare zgjedhor.

Neni 38

- 38.1 Kryesia e BD jep propozimet per nominimin e personave ne organet e Kuvendit, per numrin e keshilltareve ne zgjedhjet lokale, ndersa aprovimin me votim e merr Kryesia qendrore me shumice te thjeshte te votave.
- 38.2 Kryesia e BD ben koordinimin e zhvillimit politik me kryesine qendrore dhe KPD dhe mbane kontakte te vazhdueshme me to.
- 38.3 Kryesia e BD harton dhe miraton programin e punes per periudhen nje vjeqare.
- 38.4 Kryesia e BD mbane mbledhje te rregullta se paku dy here ne muaj ose me shpesh.

Neni 39

- 39.1 Dega e PSHDK-se eshte ajo Dege e cila numeron 31 anetare. Kuvendi I Deges zgjedhe dhe shkarkon : Kryetarin, nenkryetarin, sekretarin, arkatarin dhe 5 anetare te Kryesise. Zgjedhja behet me aklamacion.

Neni 40

- 40.1 Me nje rregullore te veqant KPD-ja percakton numrin e komisioneve. Me vote formale zgjedh anetaret e komisionit te cilet duhet te zgjedhen nga radhet e antaresise se partise.

Neni 41

- 41.1 Per interpretimin e drejte te zbatueshmerise se Statutit te PSHDK-se Kryesia themelon komisionin e veqant statutar I perber nga tre anetar, perberjen e ketij komisioni e percakton kryesia me nje vendim.
- 41.2 Vendimi qe merret nga komisioni statutar eshte I plotfuqishem dhe konsiderohet definitive per te gjitha organete partise

Neni 42

- 42.1 PSHDK-ja pushon se vepruari si parti politike me vendimin e Kuvendit te PSHDK-se ne Pajtim me ligjin ,kur numri I antaresise bie nen numrin e percaktuar me ligj ,por edhe kur mungojne mjetet materiale per veprimtarine e saje te metejshme.

Neni 43

43.1 Nese ndodh pushimi I veprimtsarise se PSHDK-se, perkatesisht nese

shuhet, ajo eshte e obliguar t'i paguaj te gjitha borgjet paraprake, ndersa mjetet

themelore te mbetura shiten permes ankandit publik

dhe me vendimin e Kuvendit te PSHDK-se, se bashku me mjetet tjera

financiare te Partise, u jepen organizatave ne vend.

DISPOZITË KALIMTARE

Neni 44

Ne baze te Marrëveshjes politike ne mese te PSHDK-se dhe PDKI-se, u arrit pajtueshmeri qe te behet bashkimi I dy subjekteve politike ne nje subjekt politik permes Kuvendit te Bashkimit. Palët jan te obliguara qe te zbatojne marreveshjen e arritur gjat bisedave te mes grupeve punuese, e cila marreveshje eshte ,mbeshtetur edhe nga kryesia e bashkuar dhe nga dy kryetaret, zt Uke Berisha ne emer te PSHDK-se dhe zt Zef Morina ne emer te PDKI-se. Pas konsultave me perfaqesuesit e KQZ-se , u pajtuam qe Kuvendi I Bashkimit deri ne unifikimin dhe konsolidimin e partise te jete njeherit edhe Kuvend zgjedhor, dhe pas mbajtjes së ketijë Kuvendi te fillohet me mbajtjen e kuvendeve zgjedhore neper dege dhe BD ne tërë territorin e Kosovës dhe ne diasporë. Kuvendi zgjedhor munde te mbahet pas konsolidimit te plote te partisë, I cili do te thirret nga Kryesia në bazë të nenit 9 te këtijë Statuti.


Neni 45

Ky Statut hyn ne fuqi dite e miratimit ne Kuvendit e PSHDK-se.

Prishtinë. 26-03-2016

Kryetari I PSHDK -së

per



zv Kryetari I PSHDK-se

